



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:049417

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05717395

**PKR.nr.59/2024**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe Agim Kuqi e Ertan Sejfulla - anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarës L.I., e akuzuar për shkak të veprës penale Trafikimi me njerëz nga neni 165, par. 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.249/2023, të datës 21.03.2024, pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 30.04.2024, në të cilin kanë qenë të pranishëm: prokurori i shtetit Bukurije Gjonbalaj, mbrojtësi i viktimave B.D. dhe e akuzuara L.I. me mbrojtësin e saj av. Mentor Neziri me autorizim, pas shqyrtimit gjyqësor, me datë 03.05.2024, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

**E akuzuara L.I.**, e bija e L. dhe I., e vajzërisë R., e lindur me datë ..., në F./ Republika e Shqipërisë, me banim të përkohshëm në Prishtinë, afër ... (adresën nuk e di), me numër të pasaportës ... dhe kartë identiteti ..., e pa arsimuar, e martuar, nënë e shtatë fëmijëve, e pa punë, shfrytëzuese e ndihmës sociale në shumë prej 8000 lekë, e gjendjes së dobët ekonomike, rome – shtetase e Republikës së Shqipërisë, **ka qenë nën masën e paraburgimit nga data 09.02.2024 deri me datë 29.03.2024.**

Konform nenit 363, par. 1, nënpar. 1.3, të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale,

## LIROHET NGA AKUZA

**S e p s e:** e pandehura që nga data e pavërtetuar e deri me 09.02.2024, duke e keqpërdorur pozitën e të dëmtuarit F.R., gjendjen e tij psikike dhe fizike, pamundësinë e tij të pavarur të komunikimit dhe jetesës, me të cilin është në lidhje familjare, e ka sjellë nga Republika e Shqipërisë në territorin e Republikës së Kosovës, përmes pikës kufitare Vërmicë, e mbi të cilin ka kontroll, kështu që, me qëllim të shfrytëzimit, e ka detyruar të dal në lokacione të ndryshme në Prishtinë, në qendër, në shesh, kryesisht në kohën e drekës, kur ekziston qarkullim i madh i njerëzve, në udhëkryqin, te semaforat në Rr. "...” dhe në rrethin e spitalit të QKUK-së, për të kërkuar lëmshë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, e të cilin përfitim ia merr e pandehura,-

- pasi që, nuk është provuar se ka kryer veprën penale Trafikimi me njerëz nga neni 165, par. 1 të KPRK.
- Shpenzimet gjyqësore, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.
- Sendet e sekuestruara si në vijim: Telefoni Samsung Gallaaxy J6+ me numër të IMEI: ... dhe ... dhe paratë në vlerë prej 94 euro e 43 cent, 980 lekë shqiptarë dhe 3 dollarë amerikanë, të sekuestruara me vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 09.02.2024, i kthehen të akuzuarës L.I., ndërsa
- Sendet e sekuestruara si në vijim: paratë në vlerë prej 13 euro e 15 cent të cilat i janë sekuestruar me vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 09.02.2024, i kthehen qytetarit F.R. ose të akuzuarës L.I., si kujdestare e tij.

## ARSYETIMI

Prokuroria Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.nr.249/2023, të datës 21.03.2024, ka akuzuar të pandehurën L.I., për shkak të veprës penale Trafikimi me njerëz nga neni 165, par. 1 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 29.03.2024 dhe në atë të shqyrtimit gjyqësor të datës 30.04.2024, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, e akuzuara L.I. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar e pafajshme për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Në fjalën hyrëse prokurori i shtetit ka deklaruar se aktakuza e ngritur ndaj të pandehurës L.I. është e mbështetur në prova të cilat do të vërtetojnë gjendjen faktike, duke i propozuar gjykatës që gjatë shqyrtimit gjyqësor t'i administroj provat materiale të propozuara në aktakuzë.

Ndërsa në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka deklaruar se me aktakuzën PP.nr.249/2023, të datës 21.03.2024, e pandehura L.I. është akuzuar për veprën penale Trafikim me njerëz nga neni 165 par.1 KPRK, dhe se me provat e siguruar në procedurën hetimore dhe ato të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës se e akuzuara ka kryer veprën penale si në aktakuzë, pastaj ka shtuar se kjo vërtetohet edhe nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë siç janë: vërtetimi mbi konfiskimin e gjësendeve i datës 09.02.2024 ku shihej se nga e akuzuara ishin konfiskuar 94 euro e 43 cent të holla këto të cilat i dëmtuari F.R. i kishte fituar duke kërkuar lëmshë, e nga kjo vërtetohet se paratë e sekuestruara ishin 20 monedha nga 1 euro, 3 kartëmonedha nga 10 euro, 3 kartëmonedha nga 5 euro, një monedhë 2 euro, 10 monedha nga 1 euro, 27 monedha nga 0.50 cent, 45 monedha nga 20 cent, 37 monedha nga 0.10 cent dhe 35 monedha nga 5 cent. Po ashtu, prokurori i shtetit ka thënë se edhe nga raporti për ekzaminimin e gjendjes shëndetësore të F.R. të datës 13.03.2024 është konstatuar se i dëmtuari ka prapambetje mendore të formës së rëndë, i njëjti ka ngecje të theksuar mendore që karakterizohet edhe me simptoma apo sjellje që hyjnë në kuadër të mos zhvillimit fizik dhe atij psikik, e të gjitha këto probleme e kufizonin dhe nuk e lejonin vënien e kontaktit të bashkëbisedimit, kjo për shkak të natyrës së çrregullimit aftësisë së kuptuarit dhe kontrollit të veprimit e kishte të përjashtuar dhe nuk ishte i aftë të konsultohej me persona të tjerë, po ashtu nga raporti i datës 01.12.2023 brenda të cilit ka fotografi, e nga i cili vërtetohet se me datë 20.11.2023 rreth orës 14:20 në sheshin “...” shihej i dëmtuari F.R. duke kërkuar lëmshë, ndërsa në anën e kundërt të sheshit qëndronte e akuzuara L.I., e cila e përcillte dhe e mbikëqyrte të dëmtuarin. Pastaj, prokurori i shtetit ka theksuar se me datë 28.11.2023 rreth orës 13:00, e akuzuara L.I. nga brenda lokalit “A...” e

vëzhgonte të dëmtuarin F.R. duke kërkuar lëmshë në rr.”...” te semaforët përballë Fakultetit Juridik në mot me shi dhe erë, pastaj pas një ore e akuzuara ka dalë nga lokali e ka sinjalizuar të dëmtuarin, pastaj së bashku nisen në drejtim të Ministrisë së Arsimit, e gjatë asaj kohe e akuzuara nga i dëmtuari ka pranuar paratë e mbledhura gjatë kërkimit të lëmshës, e pas dorëzimit të parave, i dëmtuari prapë kthehet dhe vazhdon te semaforët kërkimin e lëmshës, e kjo vërehej edhe nga fotografimi i të akuzuarës dhe të dëmtuarit, duke shtuar se, gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës vërtetohet edhe nga raporti i datës 20.11.2023 për zbatimin e masave të veçanta hetimore, vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video në vende publike ku gjatë kësaj periudhe i dëmtuari kërkim lëmshën e kishte bërë në oborrin e QKUK dhe në udhëkryqin te semaforët në rrugën “...”, ndërsa e akuzuara e kishte vëzhguar nga larg përballë tij, i kishte dërguar bukë dhe ujë, e pas dy-tri orësh kishte shkuar dhe ia kishte marrë paratë të cilat ia kishin dhuruar qytetarët gjatë kërkimit të lëmshës, e gjithashtu kjo gjendje vërtetohet edhe nga raporti i datës 09.01.2024, gjatë kësaj periudhe kohore i dëmtuari kërkonte lëmshë ndërsa e akuzuara e përcillte nga afër apo përballë rrugës në parkingun e QKUK dhe në lokalet që gjendeshin përballë këtyre lokacioneve, siç ishin furra e bukës “...” afër QKUK, lokali ”A...” në rr. “...” në Prishtinë, dhe nga fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, e me të cilat prova është vërtetuar gjendja faktike si në aktakuzë, duke shtuar se mbrojtjen e të akuzuarës gjykata duhet ta merr si të pabazuar dhe përpjekje për t’i ikur përgjegjësisë penale, pasi që një mbrojtje e tillë është në kundërshtim me provat e administruara, ashtu që nëse analizohen provat do të vërtetohet se e akuzuara e kishte kryer veprën penale e cila i vihej në barrë, prandaj prokuroria ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të akuzuarën ta shpallë fajtores dhe ta dënoj sipas ligjit, ndërsa me rastin e matjes së dënimit t’i ketë parasysh të gjitha rrethanat e parapara me ligj, e si rrethanë rënduese të merret gjendja e të dëmtuarit, i cili ka qëndruar duke kërkuar lëmshë edhe në kohë me shi dhe erë të ftoftë, derisa e akuzuara ishte paguar nga shteti shqiptar për përkujdesjen e të dëmtuarit, ashtu që përfitimin tjetër e kishte fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Në fjalën hyrëse mbrojtësi i viktimave ka deklaruar se e mbështet fjalën e hyrëse të prokurorit të shtetit.

Ndërsa, në fjalën e tij përfundimtare mbrojtësi i viktimave ka mbështetur fjalën e prokurorit të shtetit duke konsideruar se ekzistojnë mjaft prova se e akuzuara ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ka propozuar që ndaj saj të shqiptohet dënim në përputhje me ligjin.

Në fjalën hyrëse mbrojtësi i të akuzuarës L.I., av. Mentor Neziri ka deklaruar se provat e propozuara në aktakuzë pjesërisht vërtetojnë gjendjen faktike të përshkruar në aktakuzë, mirëpo mbrojtja konsideron se kualifikimi ligjor për veprën penale për të cilën akuzohet e akuzuara duke pasur parasysh që elementet e figurës së veprës penale Trafikimi me njerëz nuk janë përmbushur.

Ndërsa në fjalën përfundimtare, mbrojtësi i të akuzuarës L.I., ka deklaruar se pas administrimit të provave materiale dhe personale prokuroria pjesërisht ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike në aktakuzë, por nuk ka mundur të arsyetoj kualifikimin ligjor për veprën penale për të cilin e akuzuara L. akuzohet, pasi nuk ka qenë kontestues fakti se e akuzuara e kishte nën kujdes dhe besim të dëmtuarin F.R., për të cilin kujdesej për të gjitha çështjet elementare jetësore që nga koha kur F. ka qenë fëmijë e deri më tani, për shkak të gjendjes së rëndë fizike dhe psikike, atij i duhej përkujdesje dhe përkrahje nga personi i tretë, e për këtë kishte një ndihmë sociale nga shteti shqiptar, e të cilën ndihmë e shfrytëzonte L. kryesisht për F. Pastaj, mbrojtësi ka thënë se çështja kontestuese sa i përket gjendjes faktike kishte të bënte me atë se a e ka detyruar e akuzuara të dëmtuarin F. të dilte të kërkonte lëmshë, të grumbullonte para dhe ato para për çfarë arsye ishin shfrytëzuar, e duke pasur parasysh edhe vet arsyetimin e aktakuzës ku pjesërisht edhe

thuhej se pas mbledhjes së lëmoshës nga i dëmtuari F. e akuzuara i kishte shfrytëzuar për t'i blerë bukë, ujë etj., pra një fakt të tillë e pranon edhe prokuroria, duke shtuar se duke pasur për bazë ekspertizën mjeko - ligjore për të dëmtuarin F., i njëjti nuk është në gjendje të kuptoj e të komunikoj e as të kujdeset për veten e tij, e që patjetër i duhej ndihma e personit të tretë, i cili ishte tani e akuzuara. Prandaj, nga këto arsye, mbrojtësi ka kontestuar gjendjen faktike të përshkruar në aktakuzë që ka të bëjë me dy rrethana shumë të rëndësishme, përkatësisht detyrimin që kinse e akuzuara ia ka bërë të dëmtuarit F. si dhe shfrytëzimin e parave të mbledhura për shkak se edhe vet e akuzuara e kishte shpjeguar se si ishin shfrytëzuar mjetet e siguruar nga lëmosha, gjë të cilën e vërtetonte edhe aktakuza në arsyetimin e saj, duke theksuar se sa i përket kualifikimit të veprës penale, mbrojtja konsideron se nuk janë përmbushur elementet e figurës së kësaj vepre penale siç janë: rekrutimi, shfrytëzimi, strehimi, përdorimi i dhunës apo kanosjes për të kryer një veprim apo mosveprim, e që ka për qëllim përfitimin e kundërligjshëm material të kryesit të veprës, për shkak se e akuzuara, kujdesin ndaj të dëmtuarit F. e kishte në mënyrë institucionale dhe se e njëjta asnjëherë nuk kishte pasur dashje apo motiv që të dëmtuarin F. ta shfrytëzoj në asnjë aspekti për përfitim të saj material apo çfarëdo përfitimi tjetër dhe se e akuzuara L. çfarëdo veprimi që ndërmerret e bën vetëm me qëllim të kujdesit, edukimit dhe ushqimit, thënë përgjithësisht për të mirën e të dëmtuarit F., andaj, trupit gjykues i ka propozuar që në mungesë të figurës së veprës penale e njëjta të lirohet nga akuzat.

E akuzuara L.I. ka deklaruar se e përkrah fjalën hyrëse dhe fjalën përfundimtare të mbrojtësit të saj.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria në aktakuzë dhe e akuzuara ka dhënë mbrojtjen e saj, e të paraqitura si në vijim:

- Vërtetimi mbi konfiskimin e gjësendeve i datës 09.02.2024 shihet se nga e akuzuara janë konfiskuar 94 euro e 43 cent të holla këto të cilat i dëmtuari F.R. i ka fituar duke kërkuar lëmoshë; nga kjo vërtetohet se paratë e sekuestruara kanë qenë 20 monedha nga 1 euro, 3 kartëmonedha nga 10 euro, 3 kartëmonedha nga 5 euro, një monedhë 2 euro, 10 monedha nga 1 euro, 27 monedha nga 0.50 cent, 45 monedha nga 20 cent, 37 monedha nga 0.10 cent dhe 35 monedha nga 5 cent.

- Raporti për ekzaminimin e gjendjes shëndetësore të F.R. i datës 13.03.2024 ku është konstatuar se i dëmtuari ka prapambetje mendore të formës së rëndë, i njëjti ka ngecje të theksuar mendore po ashtu karakterizohet edhe me simptoma apo sjellje që hyjnë në kuadër të mos zhvillimit fizik dhe ati psikik, të gjitha këto probleme e kufizojnë dhe nuk e lejojnë vënien e kontaktit të bashkëbisedimit, për shkak të natyrës së çrregullimit aftësia e të kuptuarit dhe kontrollës së veprimit e ka të përjashtuar dhe nuk është i aftë të konsultohet me persona të tjerë;

- Raporti i datës 01.12.2023 brenda të cilit ka fotografi e nga i cili vërtetohet se me datën 20.11.2023 rreth orës 14:20 në sheshin “...” shihet i dëmtuari F.R. duke kërkuar lëmoshë, ndërsa në anën e kundërt të sheshit qëndron e akuzuara L.I. e cila e përcjell dhe e mbikëqyr të dëmtuarin. Me datë 28.11.2023 rreth orës 13:00 e akuzuara L.I. nga brenda lokalit “A...” e vëzhgon të dëmtuarin F.R. duke kërkuar lëmoshë në rr.”...” te semaforët përballë fakultetit juridik nëpër mot me shi dhe erë, pas një ore e akuzuara del nga lokali e sinjalizon të dëmtuarin pastaj së bashku nisën në drejtim të Ministrisë së Arsimit e gjatë asaj kohe e akuzuara nga i dëmtuari i pranon paratë e mbledhura gjatë kërkimit të lëmoshës, e pas dorëzimit të parave, i dëmtuari prapë kthehet dhe vazhdon te semaforët kërkimin e lëmoshës, kjo vërehet edhe nga fotografimi i të akuzuarës dhe të dëmtuarit.

- Raporti i datës 20.11.2023 për zbatimin e masave të veçanta hetimore, vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video në vende publike. Gjatë kësaj periudhe i dëmtuari kërkim lëmshën e ka bërë në oborrin e QKUK dhe në udhëkryqin të semaforët në rrugën “ Agim Ramadani”, e akuzuara e ka vëzhguar nga larg përballë tij, i ka dërguar bukë dhe ujë, e pas dytri orësh shkon dhe ia merr paratë të cilat ia kanë dhuruar qytetarët gjatë kërkimit të lëmshës, e gjithashtu kjo gjendje vërtetohet edhe nga

- Raporti i datës 09.01.2024 gjatë kësaj periudhe kohore i dëmtuari kërkim lëmshë ndërsa e akuzuara e përcjell nga afër apo përballë rrugës në parkingun e QKUK dhe në lokalet që gjenden përballë këtyre lokacioneve siç janë furra e bukës “Q...” afër QKUK, lokali” A...” në rr. “ ...” në Prishtinë,

- Nga fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës e për të cilat u fol në fillim të paraqitjes së provave materiale vërtetohet gjendja si në aktakuzë.

Mbrojtësi i të akuzuarës L.I., av. Mentor Neziri ka thënë se nuk ka vërejtje në provat e paraqitura nga prokuroria po ka vërejtje në përmbajtjen e tyre.

E akuzuara L.I. ka mbështetur mbrojtësin e saj për vërejtjet në provat e paraqitura nga prokurori.

Pasi është njoftuar me të drejtat e saj, në bazë të nenit 344 të KPP, e akuzuara L.I. e ka shfrytëzuar të drejtën e saj për të deklaruar dhe në pyetje nga mbrojtësi i saj, e akuzuara L.I. ishte përgjigjur se F.R. e kishte djalë të dajës, përkatësisht nëna e saj dhe babai i tij ishin vëlla e motër dhe se ajo gjatë gjithë jetës se saj ishte kujdesur për F., i cili që nga lindja kishte probleme shëndetësore, duke shtuar se në Shqipëri, F. e mbante në shtëpinë e saj së bashku me fëmijët e saj dhe me F. mund të komunikonte vetëm ajo sepse të tjerët nuk e kuptojnë. Pastaj, e akuzuara ka thënë se përveç saj askush tjetër nuk kujdeset për F., dhe se në emër të tij, në Shqipëri merr një pension në shumë prej 8.000 lek të reja që i bie rreth 80 euro dhe këto para i pranonte ajo – L., e me të cilat e mbante F. me ushqim, rroba e barna. Pastaj, e akuzuara ka thënë se F. e kishte sjellë në Prishtinë sepse kishte ardhur vet dhe i ishte dashur ta marr me vete sepse ai nuk rrinte pa të, pasi atë - të akuzuarën e dinte si nënë sepse ajo kujdesej për të, duke shtuar se në Prishtinë ajo dhe F. qëndronin në banesën e djalit të saj- V., i cili punonte në Prishtinë në ndërtim, dhe ajo- L. rrinte nga 2-3 ditë dhe kthehej prapë në Shqipëri. Po ashtu ajo mohon duke thënë se kurrë në jetën e saj nuk e kishte detyruar F. të dilte të kërkoj lëmshë, përveç se njëherë kishte dal me të për ti blerë rroba atij sepse kërkonte rroba. Pastaj ka thënë se, asnjëherë në asnjë mënyrë nuk e kishte detyruar F. të dilte të kërkonte lëmshë, sepse ajo vet kishte dal dhe kishte mbledh kanaqe për të blerë ushqim për F., dhe kur F. vet dilte kërkonte lëmshë dhe ajo kur e shihte e merrte përdore dhe shkonin në shtëpi. Paratë që i mblidhte F. i duke kërkuar lëmshë ia merrte dhe i blinte atij ndonjë bluze, pantallona, ushqim, cigare, ilaçe. F. e kishte ushqyer ajo por tani ai ishte mësuar të ushqej vet por për tu pastruar e pastronte ajo- L. duke shtuar se F. nuk është në gjendje që ti përdor ilaçet vet, dhe se ajo kujdesej për to. Pastaj ka thënë se të gjitha të hollat që i merrte F. gjatë kërkim lëmshës ajo i kishte shfrytëzuar vetëm për F. Ajo asnjëherë nuk e kishte hedhur në rrugë që të kërkonte lëmshë nga qytetarët, përkatësisht ai rrinte në shtëpi ndërsa ajo- L. dilte për të punuar. Po ashtu ka shtuar se që nga koha kur F. ishte i vogël, gjatë gjithë jetës së saj vetëm ajo ishte kujdesur për të.

Pastaj në pyetje nga prokurori i shtetit, e akuzuara ishte përgjigjur se për kujdesin e F. merrte 8.000 deri 10.000 lek shqiptare, e po ashtu edhe F. e kishte marrë pensionin e tij, duke shtuar se F. është në gjendje të dal vet nga banesa dhe të kthehet prapë, por kur ajo shkonte në Shqipëri herë pas here e merrte me vete me autobus, gjatë qëndrimit në Kosovë i kishte ndërruar

banesat sepse nuk kisha para të paguante ku rrinte 2-3 ditë dhe ikte dhe se për qiranë e banesës e paguante ajo ndonjëherë e ndonjëherë djali i saj. Pastaj ka shtuar se njëherë policia e Kosovës i kishte marrë në mëngjes në ora 06:00 në gjumë dhe i kishte dërguar deri te kufiri shqiptar , e pasi kishte mbaruar ndalesa prej 5 vitesh dhe djali punonte në Prishtinë kishte ardhur prapë, duke përsëritur se kur e shihte F. në rrugë e merrte dhe e dërgonte në banesë, pastaj ajo i blinte ushqim për të ngrënë, e kjo kishte ndodhur edhe gjatë kohës kur ishin jashtë banesës duke shtuar se gjatë kohës sa F. qëndronte jashtë banesës kishte nga 2-3 euro në gjep, dhe ia bënte me shenjë për t'i blerë për të ngrënë pasi ajo i kuptonte gjestet e tij dhe e dinte çfarë donte ai.

Në pyetje të KTGJ, e akuzuara ka thënë se banesën ku banonte me qira e paguante djali i saj V., kur kishte mundësi, duke shtuar se ka pasur raste kur F. kishte fituar nga 2,5 deri në 10 euro në ditë dhe kur ia bënte me shenjë që t'i blinte për të ngrënë, ajo ia merrte paratë dhe i blinte ushqim, ujë, rroba, cigare, kafe, ilaçe sepse edhe ajo vet punonte duke mbledhur hekurishte, kanaqe, etj., dhe se F. nuk i kishte thënë të dal në qytet për të kërkuar lëmshë pasi me F. mund të merret vesh dhe mund ta kuptoj vetëm kur ai ka nevojë për të ngrënë dhe për të pirë.

Në pyetje nga ATGJ, Agim Kuqi, e akuzuara është përgjigjur se F. nuk kupton dhe se ajo ka dalë me të për t'i blerë ilaçet e tij dhe të saj, si dhe ushqim, duke theksuar se nuk i kujtohet sa para i ka mbledhur F. atë ditë pasi ajo ishte e sëmurë për vete, përkatësisht e kishte tensionin të lartë.

Në pyetje nga ATGJ, Ertan Sejfulla e akuzuara ka thënë se në Kosovë kishte ardhur te djali i saj V., pasi ishte edhe muaji i ramazanit e pastaj do të ikte, duke shtuar se dy banesa i kishte ndërruar në Kosovë pasi nuk kishte lek t'i paguante e pastaj kishte shkuar te djali i saj.

Aktgjykimi si më lart është bazuar vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç parasheh dispozita e nenit 360 të KPP, e për të cilat do të jepet vlerësimi si në vijim:

Nga Vërtetimi mbi konfiskimin e gjësendeve i datës 09.02.2024 shihet se nga e akuzuara janë konfiskuar Telefoni Samsung Galaxy J6+ me numër të IMEI: ... dhe ... dhe paratë në shumë prej 94 euro e 43 cent, 980 lekë shqiptare dhe 3 dollarë vërtetohet se këto para janë sekustruar nga e akuzuara e kjo jo detyrimisht do të thotë se të gjitha paratë i ka fituar nga lëmshja meqenëse e njëjta ka poseduar edhe valuta te vendeve të tjera ndër to lekë shqiptare dhe dollarë amerikan, e kjo duke pasur parasysh që e akuzuara në shtetin e Shqipërisë merr një pension për kujdesin ndaj qytetarit F.R. e po ashtu merr edhe pensionin e F.R.s, më këtë është vërtetuar se vetëm posedimi i një shume të parave nuk shpreh në asnjë formë detyrimin për lëmshë të qytetarit F.R.

Nga Raporti për ekzaminimin e gjendjes shëndetësore të F.R. i datës 13.03.2024 ku është konstatuar se i dëmtuari ka prapambetje mendore të formës së rëndë, i njëjti ka ngecje të theksuar mendore po ashtu karakterizohet edhe me simptoma apo sjellje që hyjnë në kuadër të mos zhvillimit fizik dhe ati psikik, të gjitha këto probleme e kufizojnë dhe nuk e lejojnë vënien e kontaktit të bashkëbisedimit, për shkak të natyrës së çrregullimit aftësia e të kuptuarit dhe kontrollës së veprimet e ka të përjashtuar dhe nuk është i aftë të konsultohet me persona të tjerë. Nga ky raport është vërtetuar se qytetari F.R. nuk ka komunikim të rrjedhshëm, i njëjti nuk është në gjendje të përcjellë bisedën, ka paaftësi për të përqendruar vëmendjen, ka vështirësi të thella në të kuptuarit e udhëzimeve, vështirësi në kontrollimin e emocioneve dhe ka lëvizje të pakontrolluara me karakter përsëritës, përkatësisht me këtë raport është konkluduar se aftësia e kontrollës së veprimeve të veta ka qenë e përjashtuar, nga kjo gjendje e tij është vërtetuar se qytetari F.R. nuk ka aftësi në të kuptuarit e udhëzimeve, gjë që e bën të pamundur detyrimin e të akuzuarës L.I. që ta detyroj atë në kërkimin e lëmshës pasi që i njëjti nuk ka aftësi të kuptoj se çka është detyrimi apo nëse po e detyron ndokush apo jo. Pastaj, edhe vet termi trafikim me

njerëz i paraparë me nenin 165 par. 6 nënpar. 6.1 të KPRK sqaron se çka nënkuptohet me termin trafikim me njerëz, e ndër kushtet për të ekzistuar kjo veprë është që të arrihet pëlqimi i personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit, e që në këtë rast ka qenë e pamundur që të arrihet ky pëlqim, për shkak të përmendura si më lart.

Nga raporti i datës 01.12.2023, brenda të cilit ka fotografi se me datën 20.11.2023 rreth orës 14:20 në sheshin “Nënë Tereza” shihet i dëmtuari F.R. duke kërkuar lëmshë, ndërsa në anën e kundërt të sheshit qëndron e akuzuara L.I. e cila e përcjell dhe e mbikëqyr të dëmtuarin, pastaj, me datë 28.11.2023 rreth orës 13:00, e akuzuara L.I., nga brenda lokalit “A..” e vëzhgon të dëmtuarin F.R. duke kërkuar lëmshë në rr. ”...” te semaforat përballë Fakultetit Juridik nëpër mot me shi dhe erë, e pas një ore e akuzuara del nga lokali e sinjalizon të dëmtuarin pastaj së bashku nisen në drejtim të Ministrisë së Arsimit, e gjatë asaj kohe e akuzuara nga i dëmtuari i pranon paratë e mbledhura gjatë kërkimit të lëmshës, e pas dorëzimit të parave, i dëmtuari prapë kthehet dhe vazhdon te semaforët kërkimin e lëmshës, gjë që vërehet edhe nga fotografimi i të akuzuarës dhe të dëmtuarit, të kryera me raportet e datës 20.11.2023 për zbatimin e masave të veçanta hetimore, vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video në vende publike dhe raporti i datës 09.01.2024, si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, në të cilat shihen veprimet e të akuzuarës dhe të qytetarit F.R. për të cilin e njëjta ka kujdestarinë ndaj tij, mirëpo në sjelljet e saj – tani të akuzuarës nuk vërehet ndonjë formë e detyrimit apo përdorimit të forcës që të njëjtin ta detyroj për lëmshë apo përdor atë me qëllim të shfrytëzimit të tij.

Nga mbrojtja e të akuzuarës L.I. është vërtetuar se e njëjta ka raport familjar me qytetarin F.R., të njëjtin e ka djalë dajë dhe se gjatë gjithë jetës së saj ishte kujdesur për të, e i cili që nga lindja kishte probleme shëndetësore, e për këtë shkak, tani e akuzuara e mbante në shtëpi së bashku me fëmijët e saj, pastaj ajo në emër të tij merrte një pension në shumë prej 8.000 lekë të reja me të cilat e mbante F. me ushqim, rroba e barna, pastaj ka shtuar se F. e kishte sjell në Kosovë pasi që kishte ardhur edhe vet dhe i ishte dashur ta marrë me vete sepse ai e dinte si nënë dhe se paratë që i merrte F. nga lëmshja, ajo i shpenzonte për kujdesin ndaj F. sepse ai nuk është në gjendje as t’i pijë ilaçet vet dhe nuk mund të ketë komunikim për shkak të vështirësive të tij, derisa me tani të akuzuarën kuptohej me anë të gjesteve vetëm kur kishte nevojë për të ngrënë apo për të pirë.

Pas këshillimit dhe votimit, trupi gjykues ka ardhur në përfundimin që ndaj të akuzuarës L.I., për veprën penale për të cilën akuzohet, të merret aktgjykim lirues pasi që pas analizimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të provave materiale dhe mbrojtjes së të akuzuarës e në veçanti të ekspertizës së IPKF-së, sipas të cilës aftësia e të kuptuarit dhe e kontrollit të veprimeve të F.R., në kohën kur ka ndodhur rasti ka qenë e përjashtuar. Përkatësisht, bazuar në nenin 165 par. 6, nënpar. 6.1 kryesi i veprës penale duhet të ushtroj kanosje, përdorim force, apo forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit apo keqpërdorimit të pushtetit apo të një pozite të ndjeshme që të vë kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit, ndërsa F.R. sipas IPFK-së vuan nga një çrregullim i rëndë mendor, aftësia e të kuptuarit dhe kontrollit të tij ka qenë e përjashtuar, andaj tani e akuzuara edhe po të ketë dashur t’i përdorë këto forma për të krijuar elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz, nuk ka arritur ta bëjë atë sepse siç u tha më lart ka qenë e pamundur të komunikohet me F.R. ashtu siç edhe e akuzuara ka thënë gjatë mbrojtjes së saj. Në këtë rast kemi fotografitë ku shihet F.R. duke kërkuar lëmshë dhe në disa raste prapa tij vërehet edhe tani e akuzuara, situatë kjo e cila vë në mëdyshje nëse tani e akuzuara e ka detyruar R. të kërkojë lëmshë, e akuzuara ka mundur të qëndroj afër tij sepse e njëjta ka një detyrim ligjor që të kujdeset për të dhe të njëjtin e ka djalë dajë.

Po ashtu, në rastin konkret, trupi gjykues ka ardhur në përfundimin se me asnjë provë formale e as materiale nuk është vërtetuar se tani e akuzuara L.I., nga data e pavërtetuar e deri me 09.02.2024, duke keqpërdorur pozitën e të dëmtuarit F.R., gjendjen e tij psikike dhe fizike, pamundësinë e tij të pavarur të komunikimit dhe jetesës, me të cilin është në lidhje familjare, e ka sjellë nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të shfrytëzimit, e ka detyruar të dal në vende të ndryshme në Prishtinë, për të kërkuar lëmoshë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, e të cilin përfitim ia ka marrë tani e akuzuara, sepse pas analizimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të provave materiale dhe mbrojtjes së të akuzuarës e në veçanti të ekspertizës së IPKF-së sipas së cilës, aftësia e të kuptuarit dhe e kontrollit të veprimeve të F.R.s, në kohën kur ka ndodhur rasti ka qenë e përjashtuar. Përkatesisht, bazuar në nenin 165 par. 6, nënpar. 6.1 të KPRK, kryesi i veprës penale duhet të ushtroj kanosje, përdorim force, apo forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit apo keqpërdorimit të pushtetit apo të një pozite të ndjeshme që të vë kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit, ndërsa F.R. sipas IPFK-së vuan nga një çrregullim i rëndë mendor, e për këtë shkak, aftësia e të kuptuarit dhe kontrollit të tij ka qenë e përjashtuar, andaj tani e akuzuara edhe po të ketë dashur t'i përdor këto forma për të krijuar elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz, nuk ka arritur ta bëjë atë sepse siç u tha më lart, ka qenë e pamundur të komunikohet me F.R. ashtu siç edhe e akuzuara ka thënë gjatë mbrojtjes së saj. Në këtë rast kemi fotografitë ku shihet F.R. duke kërkuar lëmoshë dhe në disa raste prapa tij vërehet edhe tani e akuzuara, situatë kjo e cila vë në mëdyshje nëse tani e akuzuara e ka detyruar R. të kërkojë lëmoshë, sepse e akuzuara ka mundur të qëndroj afër tij pasi e njëjta ka një detyrim ligjor që të kujdeset për të dhe të njëjtin e ka djalë dajë. Andaj, mbi bazën e thënies si më lart, trupi gjykues ka vendosur që tani e akuzuara të lirohet nga akuzat, duke vlerësuar në favor të saj mëdyshjet lidhur me faktet e rëndësishme sa i përket fotografive përkatësisht fotografitë nuk sigurojnë provë të mjaftueshme që tani e akuzuara të shpallet fajtorë, duke pasur parasysh edhe faktin se vërtetimi mbi sekuestrimin dhe raportet e zyrtarëve policorë nuk paraqesin ndonjë rrethanë relevante që vërteton kryerjen e veprës penale nga tani e akuzuara.

Bazuar në nenin 3 par. 2 të KPP, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e dispozitave të ligjit penal, janë interpretuar në favor të të akuzuarës dhe të drejtave të saj, sipas këtij kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 363 par. 3 të KPRK, gjykata ka marrë aktgjykim për lirues për të akuzuarën L.I., sepse nuk është provuar se e njëjta ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar nga prokuroria.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi për shpenzimet procedurale u mor në bazë të nenit 454, par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve 363, par. 1, nënpar. 1.3 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 22.05.2024.



GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.59/2024, datë 03.05.2024.

Bashkëpunëtoreshë profesionale,  
Arbenita Hoxha Koleci

---

Kryetari i trupit gjykues,  
Naser Foniqi

---

**UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.